

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSQVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Nr. 991/19

Nr. i fq. / Basi

Data: / Datum 13.08.2019

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, nenit 1 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drusore nga Pyjet Publike, si dhe në bazë të propozimit. nr. prot. 43025/19 datë 07.08.2019 të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet shitja përmes procedurave të tenderimit e masës drusore në sasi prej 188.85 m³ të konfiskuar nga organet kompetente, e cila gjendet në depon e sektorit të pyjeve në Vushtri, në vendosje të përkohshme.
2. Obligohet Drejtoria për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që të inicioj procedurat e tenderimit për shitje të masës drusore të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi, konform rregullave dhe procedurave të parapara ligjore.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dt. 28 tetor 2010, dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 28.08.2019, merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. Miratohet shpronësimi për interes publik, realizimin e projektit për rregullimin e trotuarit në rrugën “Bekim Berisha-Abeja” në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë, të pronës të paluajtshme si në vijim:
 - P-70202016-02096-0, në sipërfaqe prej 155 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4777 m², ZK-Vushtrri, pronar në pjesë ideale 1/1 Kimete Aliu nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.
2. Për pronën e shpronësuar, do të paguhet kompensimi në emër dhe llogari të pronarit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, apo zotëruesit të interesit, në bazë të akt vlerësimeve të Ministrisë së Financave – Departamentit të Tatimit në pronë dt.20.05.2019.
3. Akt vlerësimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i është bashkangjitur në shtojcë.
4. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të paguhet në tërësi shuma e kompensimit për pronën e shpronësuar me këtë vendim.
5. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, i njëjti i dërgohet personit prona e të cilit është shpronësuar.
6. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, i njëjti do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Vushtri.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
9. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të të njëjtit. Ankesa paraqitet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega në Vushtri dhe ka të bëjë vetëm me kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.


Kryetari i Komunës
Xhafer Tahiri